

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ARBEN QOSJA

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore, në datën 19.10.2020 për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Qosja bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, në datën 21.10.2020, vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Qosja, prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim, nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Genta Tafa Bungo, z. Lulzim Hamitaj relator, znj. Suela Zhegu anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.